

Njoftim i përqendrimit me të cilin C E – Betajligungs-GmbH nga Gjermania dhe Z. Riçard Garner nga Austria do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Gartner Transport Holding GmbH nga Austria

(lënda nr. 08-63/ 2024)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 13.03.2024, te Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim që i referohet blerjes së kontrollit të përbashkët nga CE “ Betajligungs-GmbH me zyrë të regjistruar në Shtiftsbergshtrase 1, 74172 Nekarzulm, Gjermani dhe z. Riçard Garner (për partnerët e Gartner Transport Holding GmbH), një shtetas austriak mbi Gartner Transport Holding GmbH me një zyrë të regjistruar në Lincer Shtrase 40A-4650 Lambah, Austri.

-C E – Betajligungs GmbH është një shoqëri e varur indirekt e Lidl Shtiftung & Co. Kg (Lidl Stiftung & Co. KG), e cila është pjesë e Grupit Shvarc (Schwarz Group). Grupi Shvarc është kryesisht aktiv në shitjen me pakicë të ushqimit në më shumë se 30 shtete përmes zinxhirëve të shitjes me pakicë LIDL dhe Kaufland. Që nga viti 2018, Grupi Shvarc është i përfshirë në mbledhjen, klasifikimin, përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve si një ofruer shërbimi i integruar në fushën e menaxhimit të mbetjeve përmes divizionit të menaxhimit të mbetjeve PreZero. Brenda Grupit Shvarc, C E – Betajligungs GmbH është aktive në tregtinë dhe shpërndarjen e të gjitha llojeve të mallrave, veçanërisht produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, në menaxhimin dhe pjesëmarrjen në shoqëritë që operojnë në zonën e mësipërme, si dhe në ofrimin e të gjitha llojeve të shërbimeve për shoqëritë të tilla.

Në Maqedoninë e Veriut, Grupi Shvarc është i pranishëm nëpërmjet një shoqërie të varur të regjistruar - LIDL MAQEDONIA E VERIUT SHPKNJ SHKUP, me seli në Bul. Kiro Gligorov nr. 2, kati i 3-të, komuna Gazi Babës, 1000 Shkup, e cila nuk është aktive për momentin, por do të aktivizohet në të ardhmen e afërt, gjegjësisht do të menaxhojë dyqanet LIDL në Maqedoninë e Veriut.

-Riçard Garner, një shtetas austriak, është partner në Gartner. Nuk ka aktivitete të tjera biznesi në Austri apo ndonjë vend tjetër, përfshirë Maqedoninë e Veriut.

-Gartner Transport Holding GmbH është shoqëria udhëheqëse e Grupit Gartner. Grupi Gartner është një shoqëri familjare me seli në Lambah, Austri dhe vende të tjera në tetë vende evropiane. Grupi Gartner ofron shërbime logjistike. Aktiviteti kryesor i Grupit Gartner është transporti rrugor vendas dhe ndërkombëtar i mallrave me kamionë dhe rimorkio. Përveç kësaj, Grupi ofron transport intermodal, dhe në një masë më të vogël, shërbime magazinimi për klientët ekzistues të logjistikës së transportit dhe transportit intermodal.

Gartner Transport Holding GmbH nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut, por ka arritur shitje të kufizuara nga një klient në Maqedoninë e Veriut.

Tregu përkatës i mallrave, për qëllime të Transaksionit të Propozuar mund të përkufizohet si një *treg për logjistikën e transportit*.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen

në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të mbërrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

19.03.2024

Shkup